

STRATEGJITË

QËLLIMET KRYESORE:

Te permiresojme vazhdimisht kujdesin mjekesor ndaj pacientit. Te japim sherbime cilesore dhe akses per dhenie sherbimi pacienteve bazuar ne respekt dhe humanitet. Te rrisim vazhdimisht nivelin profesional te stafit, te krijojme nje mjedis pune te sigurte, te motivojme stafm per pune cilesore.

Te ndikojme pozitivisht ne integrimin e sherbimit tone spitalor me ate paresor, per nje bashkepunim sa me efektiv ne interes te pacientit.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE:

- Kujdesi shëndetësor cilësor me akses të plotë.
- Përmirësimi i infrastrukturës spitalore dhe kushteve të punës.
- Zbatimin dhe vlerësimin e protokolleve të mjekimit.
- Zbatimi i kodit të etikës dhe deontologjisë.
- Ngritja e vazhdueshme profesionale e personelit mjekësor.
- Zgjerimi dhe rritja e gamës së shërbimeve në spital.
- Përcaktimi i standarteve profesionale për të gjithë personelin.

PLANI YNË DO TË FOKUSOHET NË KËTO DREJTIME:

OBJEKTIVI 1.

- Dhënia e një shërbimi shëndetësor sa më cilësor.
- Standartizimi i kujdesit shëndetësor dhe forcimi i sistemit për të parandaluar dhe evituar gabimet mjekësore.
- Përmirësimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i indekseve të cilësisë.
- Zbatimi i antibiotikoprofilaksisë në ndërhyrjet kirurgjikale.
- Shfrytëzimi i kapacitetit të shtratit në nivel spitali mbi 80%
- Mbajtja e ditë qëndrimit mesatar në nivelin 4 ditë. Ulja e seksio cesareas në vlerat 30%.
- Mbajtja e mortalitetit amtar në nivel zero.
- Trendi në ulje të mortalitetit perinatal.
- Ulja e mortalitetit nga neonatal në 24 orët e para.
- Në bashkëpunim me MSHMS dhe QKCSAISH plotësimi me protokollin klinike dhe zbatimi i tyre në praktikën e përditshme.
- Kontrolli i vazhdueshëm për parandalimin e infeksioneve spitalore.
- Ngritja e grupeve përgjegjëse për monitorim.
- Zbatimi i programeve dhe protokolleve për parandalimin e infeksioneve spitalore.

- Organizimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore me qëllim realizimin e praktikës dyfishe.
- Edukimi i vazhdueshëm profesional për personelin mjekësor.
- Rritja e pergjegjësisë dhe sigurimi i aksesit për çdo pacient në nevojë.
- Shkurtimi i kohës së pritjes për marrjen e shërbimit.
- Shtrirja e mbulimit shëndetësor duke bashkëpunuar me dhënësit e tjerë të shërbimit shëndetësor në nivel qarku, në kuadër të patronazhimit.

OBJEKTIVI 2

- Riorganizimi i shërbimeve në tërësi dhe rritja e bashkëveprimit midis tyre.
- Riorganizimi dhe përforcimi i shërbimit të Pranim-Urgjencës (me zgjerimin e mjedisëve të reja, paisja me aparatura, kualifikimi i personelit dhe forcimi me tej i rolit të Triazhit).
- Pas shprehjes së interesit na u dha një mundësi e jashtëzakonshme për të investuar në një rivizionim të Shërbimit të Pranim Urgjencës dhe Qendrës së shëndetit të gruas, për të akomoduar rritjen e ardhshme dhe për të përmirësuar punën tonë të përbashkët drejt realizimit të misionit tonë.
- Planifikimi dhe rinovimi i hapsirës ekzistuese do të përmirësojë ndjeshëm funksionalitetin e shërbimeve për pacientët, e kontrollit të aktivitetit dhe personelit mjekësor; shfrytëzimin me eficiencë kapaciteteve dhe numrin e shtretërve të urgjencës etj.

Objektivi nr 3

- Përmirësimi i vazhdueshëm i menaxhimit të burimeve financiare për rritjen e efikasitetit dhe eficiencës së shërbimeve.
- Të rrisim kosto eficientë.
- Monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i indekseve të cilësisë.
- Të ndiqet kosto për pacient sipas grup diagnostik, për diagnostat kryesore spitalore.
- Të përmirësohet procedura e planifikimit dhe tenderimit të medikamenteve e materialeve të mjekimit.
- Të reduktohen në maksimum humbjet e panevojshme financiare (sidomos medikalizimi i panevojshëm; konsumi i materialeve të mjekimit; uje, energji elektrike, karburant, telefon etj.)